



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Gusht 2023

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Gusht 2023

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin gusht të vitit 2023)**

Reagim i Këshillit Prokurorial ndaj deklaratave të deputetit Hisen Berisha

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), reagon ndaj deklaratës së deputetit të Kuvendit të Kosovës, Hisen Berisha, të publikuar sot në mediumin online "Paparaci.com", i cili me gjuhë shpifëse dhe të pavërtetë ka goditur figurën e Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi.



KPK-ja, deklaron se kjo gjuhë e përdorur nga deputeti Berisha është e dëmshme dhe tërësisht e paqëndrueshme dhe nuk përkon aspak me rolin dhe mandatin, të cilin e ka një deputet i Kuvendit të Kosovës.

Deklarimet e deputetit Berisha nuk janë gjë tjetër veçse një ndërhyrje e drejtpërdrejtë në sistemin prokurorial, sepse U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, është zgjedhur në këtë detyrë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës si institucion i veçantë kushtetues, e jo nga Qeveria apo ndonjë institucion tjetër.

Reagim i Këshillit Prokurorial i Kosovës ndaj deklaratave të Kryeministrit të Kosovës dhe ministrave të kabinetit qeveritar

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) reagon ashpër ndaj deklaratave me përmbajtje tejet tendencioze, të pavërteta e linçuese ndaj Institucionit të Prokurorisë dhe prokurorëve të saj, të bëra dje dhe sot nga ana e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ministrave të kabinetit qeveritar, mbi bazën e paragjytimeve dhe hamendësive, duke tentuar të

godasë sistemin prokurorial në çdo mënyrë dhe në çdo rast.

KPK-ja i bënë thirrje Kryeministrit dhe ministrave të kabinetit të tij qeveritar që të përmbahen nga deklaratat e vazhdueshme shantazhuese dhe rrjedhimisht nënçmuese, ndaj sistemit prokurorial të Kosovës në përgjithësi dhe ndaj punës së prokurorëve në veçanti, duke tentuar të linçojnë publikisht çdo gjë që ka të bëjë me sistemin prokurorial dhe punën e prokurorëve të shtetit.



KPK-ja, thekson në mënyrë të qartë dhe të palëkundur se deklaratat dhe akuzat e tilla të pabaza dhe qasja e tillë e një pushteti tjetër, duke sulmuar dhe linçuar kryeprokurorët dhe prokurorët me emra dhe mbiemra, është shkelje e patolerueshme dhe tentativë e dështuar për të ndërhyrë në punën e pavarur të Prokurorit të Shtetit.

Gjithashtu, KPK-ja, deklaron se do të mbështesë fuqishëm dhe do të mbrojë me të gjitha mjetet juridike-ligjore, që ka në dispozicion, punën profesionale të të gjithë prokurorëve të Republikës së Kosovës dhe, më këtë rast, u bënë thirrje publike të gjithë faktorëve, në veçanti, Qeverisë së Kosovës që të qëndrojnë larg deklaratave të tilla, tentativave për ndërhyrje dhe presione të drejtpërdrejta dhe të kota, që bien në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Prandaj, KPK-ja dënon keqpërdorimin e fjalës së lirë nga ana e Kryeministrit dhe ministrave të tij, duke theksuar se këto deklaratat janë krejt të kota ndaj Prokurorit të Shtetit, i cili nuk ndikohet nga qarqet politike dhe grupet e interesit, por si institucion i pavarur dhe i paanshëm në ushtrimin e mandatit të vet do t'i shkojë deri në fund çdo rasti me dyshim për keqpërdorim të parasë publike dhe në dëm të qytetarëve të Kosovës, pavarësisht kush është, në çka beson dhe çfarë ka bërë.

Këshilli Prokurorial është i përkushtuar me të gjithë mekanizmat e tij që të punojë, mbrojë dhe avancojë çdo vlerë të integritetit, dinjitetit dhe transparencës publike, si dhe të luftojë çdo tendencë për presion dhe ndërhyrje nga ana e kujtdoqoftë.

KPK-ja bënë thirrje që Prokurori i Shtetit, puna dhe misioni i tij, të jenë jashtë çdo agjende të politikës ditore, sepse vlerësimi i punës së prokurorëve nuk varet nga vullneti i individëve, subjekteve dhe grupeve të caktuara dhe as këto deklaratat dhe veprime jokorrekte, joetike dhe të padinjitetshme nuk do të arrijnë të zbehin punën e prokurorëve.

KPK-ja potencon se Prokurori i Shtetit, si pjesë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë në vendin tonë, do të punojë intensivisht për ndriçimin deri në fund të të gjitha rasteve në punë, ndaj të gjithë atyre zyrtarëve të dyshuar dhe të veshur me pushtet, pavarësisht tentativave për ndërhyrje, duke vënë në pah përfundimisht dhe me konsekuencë se pavarësia e sistemit prokurorial është thelbësore dhe e rëndësishme në rrugën që kemi përpara.

Anëtarët e Komisionit për Çështje Normative mbajnë takim e radhës

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryetari i këtij Komisioni, Armend Zenelaj, së bashku me anëtarin, Bahri Hyseni, në bashkëpunim me U.D. Drejtorin e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Shqipe Hykolli, kanë mbajtur takimin e radhës në të cilin është diskutuar Plan i Punës së Komisionit për vitin 2023, Realizimi i Planit të Punës për gjashtë (6) mujin e parë të vitit 2023, si dhe Realizimi i Planit të Punës për gjashtë (6) mujin e dytë 2023.



Përveç Planit të Punës, Komisioni ka punuar drejtë finalizimit të draft Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit, si dhe, draft Rregullore për administrimin dhe Arkivimin e dokumenteve në institucionin e prokurorit të Shtetit, për të cilat Komisioni është pajtuar se si të procedohet tutje me këto dy draft rregullore.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i udhëhequr nga zëvendëskryesuesi i KPK-së, Veton Shabani, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e Komisionit dhe udhëheqës të njësive organizative nga Sekretariati i KPK-së dhe NJSHP-së.

Qëllimi i mbajtjes së këtij takimi ishte diskutimi për raportet analitike për numrin e nevojshëm të prokurorëve të Prokurorisë së Apelit dhe Departamentit të Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.



Po ashtu, gjatë këtij takimi është diskutuar edhe për draft-formën e raportit mujor të administratorëve lidhur me kontrollin e kualitetit të të dhënave, si dhe është diskutuar për efektet e punëtorisë e cila është mbajtur gjatë muajit korrik 2023 lidhur me zbatimin e SMIL-it nëpër prokurori, për ngritjen e efikasitetit në punë dhe rritjen e transparencës institucionale.

Në fund të takimit anëtarët e Komisionit nxorën propozime për trajtimin e rekomandimeve të dala nga punëtorja në fjalë në drejtim të kontrollit dhe ngritjes së kualitetit të të dhënave në SMIL.

Mbahet Takimi i 233-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Jetish Maloku, ka mbajtur sot takimin e 233-të me radhë, sipas agjendës së paraparë.

Gjatë këtij takimi, para anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kanë raportuar kryeprokurorët e prokurorive të Republikës së Kosovës, për periudhën prill – qershor 2023.

Po ashtu, gjatë këtij takimi janë miratuar dy raporte; aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik për

periudhën prill - qershor 2023 dhe ai i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për veprat penale karakteristike për periudhën janar – qershor 2023.



Në këtë takim, Këshilli mori vendim për transferimin e përhershëm të prokuroreve Albana Parduzi dhe Ajtene Zoni nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Ferizaj në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Po ashtu, u avancuan në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës prokurorët Shpëtim Peci dhe Sebahate Hoxha Pepaj.

Po në këtë takim, Këshilli mori vendim për hapjen e konkursit për avancimin e tre (3) prokurorëve në Prokurorinë e Apelit.

Këshilli, pas votimit të fshehtë të kandidatëve të nominuar nga kryeprokurorët e prokurorive, plotësoi Komisionin e Vlerësimit të Performancës së prokurorëve me një anëtar të ri, prokuroren Nazan Shero nga Prokuroria Themelore në Prizren, pas daljes në pension të anëtarit paraprak.

Në vazhdim, Këshilli mori vendim për propozimin për lirim nga detyra të prokurores Slavica Mavric, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe prokurorit Taulant Atashi, për shkak të ofrimit të dorëheqjes.